

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E HËNË 11 PRILL 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kur e sollëm për herë të parë idenë e bashkëqeverisjes, jo pak njerëz e konsideruan si diçka kalimtare, të momentit, madje opozita e quajti si “demagogji” apo “propagandë” të qeverisjes, por koha e tregoi se bashkëqeverisja ishte një mekanizëm i ri për të institucionalizuar marrëdhënien me qytetarët, për të dëgjuar zërin e tyre, si dhe për të shmangur burokracitë në zgjidhjen e shpejtë të problemeve të tyre të përditshme. Bashkëqeverisja rezultoi një koalicion real me njerëzit e zakonshëm të këtij vendi dhe i bëri realisht ata pjesë të procesit vendimmarrës.

Bashkëqeverisja asnjëherë nuk i anashkaloi institucionet, por përkundrazi, rriti performancën e tyre dhe u konsolidua si një institucion i qëndrueshëm përmes ligjit. Në këtë mënyrë, ajo nuk i shërben vetëm kësaj qeverie, por do të vazhdojë të funksionojë si një instrument efektiv për çdo qeverisje. Madje edhe vetë qytetarët tashmë janë ndërgjegjësuar për seriozitetin dhe efikasitetin e platformës, saqë tashmë ata nuk kanë më nevojë t’i telefonojnë deputetit të zonës apo drejtuesve të institucioneve, siç e kanë bërë tradicionalisht ndër vite, për të zgjidhur hallet dhe shqetësimet e tyre, sepse përgjigjen, në shumicën e rasteve, edhe zgjidhjen, e marrin më të shpejtë e më ligjore nëpërmjet bashkëqeverisjes. Bazuar në suksesin e kësaj eksperience, qeveria që në fillimin e këtij mandati hodhi një hap të ri për t’u konsultuar me qytetarët për problematika që janë shumë të ndjeshme për ta apo për dilema të ndryshme të qeverisjes, për të cilat nevojitet mendimi i tyre për një vendimmarrje sa më të drejtë.

Këshillimi Kombëtar me qytetarët është një hap i ri, një cilësi e re, që e bën bashkëqeverisjen akoma më konkrete dhe më solide, dhe qytetarët akoma më të përfshirë në vendimmarrje dhe politikëbërje. Natyrisht, kjo nuk është një shpikje jona, por njihet dhe aplikohet si formë e demokracisë së drejtpërdrejtë edhe në vendet më të zhvilluara për të siguruar qartësi dhe transparencë në vendimmarrje. Këshillimi Kombëtar gjeti një mbështetje të gjerë nga shqiptarët pa dallime partiake. Më shumë se 500 mijë qytetarë shprehën lirshëm dhe në privatësi të plotë qëndrimet dhe opinionet e tyre. Ky fakt, kjo pjesëmarrje masive, përtej qëllimit kryesor pse lindi këshillimi, është tregues i ndërgjegjësimit dhe emancipimit të mëtejshëm të qytetarëve, për të qenë aktiv dhe për të vënë edhe ata një gur në politikën zhvilluese të vendit.

Tashmë qeveria është e angazhuar dhe ka përgjegjësinë që vullnetin e qytetarëve ta jetësojë përmes akteve vendimmarrëse, ligjore apo nënligjore. 81% e shqiptarëve, që kanë marrë pjesë në këshillim, janë të mendimit që nënat me 3 ose më shumë fëmijë të mitur duhet të përfitojnë mbrojtje të veçantë sociale nga shteti. Ky është një ndër konfirmimet më të larta, që duhet të përkthehet absolutisht, sa më shpejt të jetë e mundur, në një paketë konkrete mbështetëse për nënat, që të lehtësojmë misionin e tyre për të rritur dhe edukuar fëmijë të shëndetshëm, për familjen dhe për shoqërinë tonë. Mbështetja

e veçantë për nënat më fëmijë të mitur nuk është një politike e re, por një angazhim i ri, një hap më shumë në vazhdim të politikave sociale që qeveria ka ndërmarrë vitet e fundit për familjet, por edhe shtresat më vulnerabël. Një nga përparësitë më kryesore në këtë drejtim do të jetë padyshim mbështetja e vazhdueshme për arsimimin e fëmijëve, duke filluar që nga arsimi parashkollor.

Tashmë të gjithë fëmijët e sistemit arsimor bazë, nga klasa e parë në të nëntën, përfitojnë tekste shkollore në përdorim falas. Ndërkohë, 14 kategori të shtresave në nevojë i përfitojnë tekstet falas dhe në arsimin e mesëm. Po ashtu, ne hartojmë dhe implementojmë politika që luftojnë braktisjen shkollore nga fëmijët e shtresave më në nevojë, me bursa apo programe të veçanta, edhe pse ky fenomen në shifra është shumë i ulët. Ndërkohë, së fundi kemi rritur me 50% rimbursimin e transportit për nxënësit që banojnë mbi 2 kilometra larg nga shkolla ku mësojnë. Pa dyshim që duhet të bëjmë akoma më shume dhe Këshillimi Kombëtar është pikërisht një mënyre e re si t'i bëjmë më mirë dhe më drejt politikat tona. Akoma e më i lartë është konfirmimi që shqiptarët japin për ashpërsimin e dënimit të autorëve përsëritës në kryerjen e krimeve të renda, duke dyfishuar dënimin për ta, përfshirë edhe dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve, një shqetësim i kahershëm ky, jo vetëm për gratë dhe vajzat, por për të gjithë shoqërinë dhe që kërkon adresim të menjëhershëm dhe mbështetje të të gjitha forcave politike, brenda dhe jashtë Parlamentit, shoqërisë civile dhe çdo aktori tjetër.

Të dashur qytetarë,

Ne jemi të vendosur që Këshillimi Kombëtar, pas mbështetjes suaj të gjerë, të jetë jo vetëm busull orientimi për qeverisjen, por sidomos të jetë një mekanizëm konsultimi i vazhdueshëm, për të bërë më të mirën në misionin tonë për siguri, përkujdesje dhe zhvillim. Faleminderit!